



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 326 Akti

Nr. 274 Vendimi
Tiranë, më 16.7.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	Kryesues
Valbona Sanxhaktari	Relatore
Xhensila Pine	Anëtare

në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh, asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Gledis Hajdini, në datën 14.7.2020, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Spartak Çoçoli**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi gjetjet dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, mbështetur në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Spartak Çoçoli është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe në bazë të nenit 179/b/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i nënshtrohet rivlerësimit, *ex officio*.

2. Z. Spartak Çoçoli u shortua në datën 12.11.2019. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Valbona Sanxhaktari dhe anëtarë komisionerët Xhensila Pine dhe Lulzim Hamitaj. Trupi gjykues ka zgjedhur kryesues për këtë çështje komisionierin Lulzim Hamitaj. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar znj. Mia Roessingh.

3. Në datën 19.11.2019 trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016 dhe në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues.

4. Në datën 4.12.2019 subjekti i rivlerësimit u njoh me përbërjen e trupit gjykues dhe me të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarinimin e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues dhe deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e këtij trupi.

5. Bazuar në nenet 33, 39 e 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

6. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nga pika 5, e nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

7. Në datën 29.5.2020, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, u njoh me rezultatet e hetimit dhe me provat e mbledhura, duke vendosur mbylljen e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Spartak Çoçoli, mbështetur në dy kriteret e vlerësimit, të figurës dhe profesional, e në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i kaloi subjektit barrën e provës për të paraqitur shpjegime të tjera dhe për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

8. Komisioni njoftoi subjektin e rivlerësimit, z. Spartak Çoçoli, në datën 2.6.2020, nëpërmjet postës ekelektronike, për përfundimin e hetimit kryesisht dhe kalimin e barrës së provës, si dhe iu bënë me dije të drejtat në bazë të ligjit për t’u njohur me dosjen dhe për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, lidhur me rezultatet e hetimit.

9. Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me dosjen, në datën 17.6.2020 ka paraqitur një kërkesë për zgjatjen e afatit për dorëzimin shpjegimeve dhe provave lidhur me rezultatet e hetimit, duke paraqitur argumentet e tij. Komisioni, pasi u njoh me këtë kërkesë, e pranoi duke shtyrë afatin për dorëzimin e rezultateve të hetimit nga data 17 qershor 2020 për në datën 25 qershor 2020, si dhe njoftoi subjektin e rivlerësimit.

10. Në datën 25.6.2020 subjekti ka paraqitur një kërkesë tjetër për zgjatjen e afatit për dorëzimin e shpjegimeve dhe provave lidhur me rezultatet e hetimit. Komisioni, pasi u njoh me kërkesën e subjektit dhe shkaqet e paraqitura, e pranoi duke shtyrë afatin për dorëzimin e rezultateve të hetimit në datën 29 qershor 2020, si dhe njoftoi subjektin e rivlerësimit.

11. Në datën 29.6.2020 subjekti dërgoi me anë të postës elektronike shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit, në të cilat kërkonte riçeljen e hetimit administrativ edhe për kriterin e vlerësimit të pasurisë.

12. Komisioni, pasi ka marrë shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe ka vlerësuar kërkesën e tij, ka njoftuar subjektin se nuk e pranon këtë kërkesë për riçeljen e hetimit dhe përfshirjen edhe të kriterit të vlerësimit të pasurisë, pasi deri në këtë fazë të hetimit janë konstatuar problematika lidhur me kriterin e vlerësimit të figurës dhe atë profesional, për të cilin i ka kaluar barrën e provës për të dhënë shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

Në vijim, Komisioni ka ftuar subjektin e rivlerësimit, z. Spartak Çoçoli, në seancë dëgjimore në datën 3.7.2020.

13. Në datën 3.7.2020, ora 11:41, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një kërkesë për shtyrjen e seancës dëgjimore për shkaqe shëndetësore. Komisioni ka pranuar kërkesën dhe ka njoftuar subjektin se seanca dëgjimore e radhës do të jetë në datën 14.7.2020.

14. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në datën 14.7.2020, ora 12:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh. Në këtë seancë nuk ishte i pranishëm subjekti i rivlerësimit, i cili kishte njoftuar Komisionin në datën 14.7.2020, ora 09:31, se është në pamundësi shëndetësore për t'u paraqitur dhe po e lë në çmim të trupit gjykues vazhdimin ose jo të procesit, kërkesë të cilën trupi gjykues pasi e vlerësoi vendosi vazhdimin e seancës dëgjimore.

15. Trupi gjykues, pasi zhvilloi seancën dëgjimore publike të datës 14.7.2020, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve, vlerësoi shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe në vijim të rezultateve të hetimit, arrin në përfundimin se provat e administruara gjatë hetimit administrativ nga Komisioni, për kriterin e vlerësimit të figurës dhe atë profesional, kanë nivelin e provueshmërisë dhe subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës.

16. Trupi gjykues, referuar parashikimeve të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe të vendimit nr. 3, datë 17.7.2018, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pika 16, e seksionit III, vlerëson se kur provat kanë nivelin e provueshmërisë, vendimi mund të merret bazuar vetëm në atë kriter vlerësimi.

17. Vendimi mbi përfundimin e procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Spartak Çoçoli, vetëm mbi kriterin e vlerësimit të figurës dhe atë profesional, nuk përbën në asnjë rast gjë të gjykuar për kriterin e vlerësimit të pasurisë.

II. PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

18. Procesi i rivlerësimit, i cili kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Anëtarët e Komisionit hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie* lidhur me rrethanat e çështjes.

19. Në përfundim të hetimit administrativ, kur Komisioni krijoi bindjen se provat lidhur me vlerësimin e figurës dhe atë profesional, kanë nivelin e provueshmërisë, vendosi të mbyllë hetimin kryesisht, të mbështetur në dy kritere vlerësimi dhe t'i japë të drejtën subjektit të njihet me rezultatet e këtij hetimi, si dhe me të gjithë dokumentacionin e administruar në dosje.

A. VLERËSIMI I FIGURËS

20. DSIK-ja ka dërguar, në datën 2.11.2017, raport mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, i cili nuk përfshin mendimin e njërit prej autoriteteve verifikuese të përcaktuara në kreun V të ligjit nr. 84/2016, duke konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës për këtë subjekt rivlerësimi. Në datën 28.3.2018, DSIK-ja përcjell përgjigjen e njërit prej autoriteteve verifikuese, të klasifikuar sekret.

21. Në datën 19.1.2020, Komisioni i ka kërkuar DSIK-së përditësimin e raportit të datës 2.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, duke përfshirë edhe përgjigjen e njërit prej tri autoriteteve verifikuese sipas kërkesave të kreut V të ligjit nr. 84/2016, si dhe deklasifikimin e tij.

22. Në datën 25.1.2020, DSIK-ja përcjell informacion shtesë nga autoritetet verifikuese për subjektin e rivlerësimit, z. Spartak Çoçoli, të klasifikuar sekret, dhe në datën 10.3.2020, dërgon raportin e rishikuar, të deklasifikuar pjesërisht. Në këtë raport, Grupi i Punës konstaton *papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit, z. Spartak Çoçoli.*

23. Në raport¹ argumentohet se mbështetur në të dhënat që disponohen, aktualitetin e tyre, si dhe kohëzgjatjen më shumë se një herë dhe të shtrirë vazhdimisht në kohë, të përfshirjes apo implikimit në veprimtari të kundërligjshme, e gjen subjektin e rivlerësimit në papajtueshmëri të plotë me ushtrimin e detyrës së tij funksionale.

Grupi i Punës, mbështetur në materialet që disponon, në përfundim gjykon se veprimtaria korruptive e subjektit të rivlerësimit, në bashkëpunim, cenon drejtpërdrejt pastërtinë e figurës duke e vlerësuar subjektin si një individ të mundshëm për t'u vënë nën presion nga struktura kriminale.

24. Mbështetur në informacionet e marra nga burime publike, në datën 6.2.2020, i është kërkuar Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar mbi informacionet që disponojnë lidhur me procedimet penale në ngarkim të subjektit të rivlerësimit.

24.1 Prokuroria, me shkresën e datës 17.2.2020, ka informuar se Prokuroria për Krimet e Rënda Tiranë, në datën 14.1.2019, ka regjistruar procedimin penal nr. ***, në ngarkim të shtetasve:

- a. Spartak Çoçoli, i dyshuar për veprën penale “korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal;
- b. E.D., i dyshuar për veprën penale “korrupsion aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 319 dhe 25 të Kodit Penal;
- c. E.H., i dyshuar për veprën penale “korrupsion aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 319 dhe 25 të Kodit Penal.

24.1.1 Nga analizimi i fashikullit penal ka rezultuar se:

- a. Në datën 14.1.2019 është urdhëruar regjistrimi i procedimit penal nr. ***, për veprën penale të korrupsionit aktiv të gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë, po ashtu edhe regjistrimi i emrit të personit që i atribuohet vepra penale si person nën hetim, prokurorit Spartak Çoçoli, pasi dyshohet për veprën e parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal.
- b. Me vendimin nr. 12, datë 24.1.2019, të Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krimet e Rënda Tiranë është caktuar ndaj subjektit masa e sigurimit personal me karakter ndalues: “pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik”, parashikuar nga neni 267/2 i Kodit të Procedurës Penale.
- c. Në datën 21.6.2019, prokurori i çështjes ka vendosur të marrë të pandehur shtetasin Spartak Çoçoli për veprën e parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal.
- ç. Në datën 8.7.2019, prokurori ka paraqitur kërkesën për gjykimin e çështjes penale nr. ***, të vitit 2019, ku një nga të pandehurit është edhe prokurori Spartak Çoçoli.
- d. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 30.10.2019, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit për dërgimin në gjykim të çështjes penale.
- dh. Aktualisht kjo çështje po gjykohet me procedurë gjykimi të shkurtuar.

24.2 Nga të dhënat e nxjerra nga arkiva pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda rezulton se ndaj subjektit ka pasur një kallëzim penal nr. ***, nga një shtetas me pretendimin se prokurorët Spartak Çoçoli dhe A. Z., i kanë kërkuar para në shkëmbim të rrethanave favorizuese, për të cilin është vendosur mosfillim në datën 7.7.2015.

24.2.1 Nga verifikimi rezulton se kjo çështje lidhet me kallëzimin e bërë nga shtetasi F. K., në portalin *online* “Stop korrupsionit të Ministrisë së Drejtësisë”. Në ankesën e tij, qytetari shprehet se i është mbajtur dokumentacioni i mjetit kundrejt përfitimit të paligjshëm nga disa prokurorë.

¹Për më shumë referojuni raportit.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka disponuar me faktin se procedimi penal nuk mund të fillojë pasi faktet e pretenduara nuk parashikohen nga ligji si vepër penale, për këtë arsye është disponuar bazuar në germën “ç” të nenit 290/1, si dhe në nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale.

24.2.2 Bazuar në procesverbalin e datës 3.6.2015, nga personat që tregojnë rrethana të dobishme për qëllimet e hetimit, shtetasi F. K., nuk ka deklaruar apo pretenduar se subjekti i ka kërkuar para, por ka deklaruar se shoferi i Prokurorit të Rrethit Gjyrokastër, z. A. P., i ka kërkuar shumën 2.000 (dy mijë) euro.

24.2.3 Për këtë kallëzim penal është vendosur mosfillimi në datën 7.7.2015.

25. Komisioni, nisur nga informacioni i ardhur, bazuar në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016, analizoi në tërësi provat e administruara dhe në përfundim të këtyre hetimeve rezultoi se përmbajtja e këtyre materialeve përputhet dhe mbështet informacionin e ardhur nga organet ligjzbatuese, duke krijuar bindje në vërtetësinë e informacionit të ardhur nga autoritetet verifikuese.

26. Në përfundim të verifikimeve lidhur me vlerësimin e figurës, Komisioni, i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit për të paraqitur prova e për të dhënë shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën në lidhje me rezultatet e hetimit.

27. Në shpjegimet për rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka mohuar të ketë dijeni për rastet e cituara në raportin e DSIK-së dhe se nuk kupton se për cilat raste bëhet fjalë. Në vijim, subjekti i rivlerësimit shprehet: *“Të nderuar anëtarë të trupit gjykues, në lidhje me rezultatin përfundimtar të arritur nga ana juaj, në lidhje me komponentin e figurës për personin tim, subjektin e rivlerësimit Spartak Çoçoli, konstatoj se është i gabuar. Në asnjë rast të konstatuar nga ana juaj nuk vërtetohet apo të ketë dyshime, për përfshirjen nga ana ime në veprimtari të kundërligjshme, korruptive, apo të kem pasur kontakte të papërshtatshme. Gjetjet tuaja nuk i përkasin standardeve të përcaktuara nga neni 38, pika 4, e ligjit nr. 84/2016 për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Duke iu referuar nenit 38/1 të këtij ligji rezultoi se kontrolli i figurës për së pari zhvillohet duke u ‘bazuar në prova të sakta’. Nga ana ime këto prova në raportin tuaj përfundimtar rreth figurës së subjektit të rivlerësimit, Spartak Çoçoli nuk u gjetën në asnjë rast.*

Për sa më sipër, kërkoj që të konfirmohem si i përshtatshëm për të vazhduar detyrën e prokurorit, për sa i përket komponentit të figurës.”

28. Në përfundim, Komisioni vlerëson se referuar standardit të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit nuk i atribuohet asnjë kontakt i çfarëdolloji me subjekte që janë përfshirë apo dyshohen si pjesëtarë të strukturave të organizuara kriminale.

29. Trupi gjykues i Komisionit vlerëson se fillimi i procedurës për kontrollin e figurës, bazuar në nenin 35 të ligjit nr. 84/2016, referon fillimisht mbi verifikimin e afatit të dorëzimit të deklaratës për kontrollin e figurës sipas shtojcës nr. 3 të këtij ligji dhe më tej mbi verifikimin e saktësisë së saj në përputhje me standardet e plotësimit, sipas pikave 6 dhe 7, të nenit 38 të këtij ligji.

Sipas pikës 2 të nenit 39, raporti i DSIK-së duhet të përcaktojë nëse subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi; nëse ka informacion në deklarimin e tij ose gjetkë, që tregon se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, si dhe konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë e tij për vazhdimin ose jo të detyrës.

30. Gjatë hetimit nga Komisioni nuk rezultoi për subjektin e rivlerësimit ndonjë nga rrethanat e parashikuara të pikës 6, të nenit 38, të ligjit nr. 84/2016. Në raportin e përditësuar të DSIK-së, me nr. {***} prot., datë 9.3.2020, citohet se nga të dhënat që disponohen për subjektin e rivlerësimit vlerësohen për aktualitetin e tyre, kohëzgjatjen, pra, më shumë se një herë të përfshirjes apo implikimit në veprimtari të kundërligjshme në formën e korrupsionit pasiv të prokurorit, në papajtueshmëri të plotë me ushtrimin e detyrës. Në përfundim, Grupi i Punës,

bazuar në germat “b” dhe “c”, të nenit 37, të ligjit nr. 84/2016, ka konkluduar duke e vlerësuar subjektin si individ të mundshëm për t’u vënë nën presion nga strukturat kriminale, duke pasqyruar rrethana, të cilat lidhen drejtpërdrejt me veprimet e mosveprimet e dyshuara të subjektit të rivlerësimit.

31. Qëllimi dhe fryma e ligjit nr. 84/2016, në lidhje me kontrollin e figurës, kërkon që procesi i rivlerësimit të identifikojë gjyqtarët dhe prokurorët, të cilët kanë integritet të cenuar, duke i përjashtuar ata nga sistemi i drejtësisë. Ligji, duke urdhëruar verifikimin, nëse subjektet kanë kontakte të papërshtatshme, nuk mund të përjashtojë verifikimin e figurës së subjektit, nëse ka dyshime të bazuara se ai është përfshirë në krimin e organizuar, sipas pikës 8, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, konkretisht në korrupsion pasiv. Korrupsioni në sistemin e drejtësisë lidhet me ndikimet e padrejta që prekin pavarësinë e drejtësisë si sistem dhe/ose pavarësinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve si individë.

Rëndësia e integritetit të figurës së gjyqtarit apo prokurorit është theksuar në një numër aktesh ndërkombëtare, si: “Parimet themelore të pavarësisë së sistemit të drejtësisë” i OKB-së, 1985; “Parimet e Bangalor-it për sjelljen në sistemin gjyqësor”, 2002; “Udhëzuesi evropian për etikën dhe sjelljen e prokurorëve” i Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Evropianë, 2005 etj.

32. Trupi gjykues i Komisionit vlerëson se rrethanat që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, përcaktohen në pikën 4 të nenit 38 dhe janë kur: *“a) subjekti i rivlerësimit është fotografuar ose kur një dëshmitar përshkruan një takim me një person të përfshirë në krimin e organizuar; b) subjekti i rivlerësimit ose personi i lidhur me të ka pasur një komunikim jorastësor me një person të përfshirë në krimin e organizuar; c) subjekti i rivlerësimit ose një person i lidhur me të ka shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar; ç) subjekti i rivlerësimit ka lidhje të ngushta me një person të përfshirë në krimin e organizuar; d) subjekti i rivlerësimit merr pjesë ose është i pranishëm në takime me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar. Anëtarësia e dyshuar e personit në krimin e organizuar duhet të jetë e njohur, e publikuar, ose të jetë një çështje e dokumentuar në regjistrat përkatës.”* Pika 3, e nenit 15, të ligjit nr. 84/2016 parashikon që një person të konsiderohet “i përfshirë në krimin e organizuar”, duhet të jetë dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar (në vijim, ligji nr. 10192/2009, i ndryshuar).

33. Trupi gjykues i Komisionit vlerëson se konstatimi i DSIK-së për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës, nuk lidhet me saktësinë dhe vërtetësinë e plotësisë të deklaratës së figurës, pasi nga rrethanat e konstatuara nga Grupi i Punës së DSIK-së dhe nga Komisioni për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, nuk rezultojnë të ketë bërë deklaram të pamjaftueshëm, sipas parashikimeve të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016.

34. Trupi gjykues i Komisionit vlerëson se nuk u provua që subjekti i rivlerësimit të jetë në kushtet e nenit 61, pika 2 apo 3, të ligjit nr. 84/2016 dhe për këtë arsye vlerëson se ka kryer deklaram të saktë në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, por konstatimet e gjetura gjatë hetimit mund të vlerësohen në tërësi të çështjes lidhur me rivlerësimin e subjektit, z. Spartak Çoçoli, brenda përcaktimeve të tjera të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

B. VLERËSIMI PROFESIONAL

35. Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit është bazuar në raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit dhe të dhënat nga burimet arkivore të rivlerësimit, të kryer nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Kriteret e vlerësimit janë të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe denoncimet e paraqitura në Komision.

36. Gjatë periudhës së vlerësimit, subjekti ka përzgjedhur dhe ka paraqitur bashkëngjitur formularit të vetëvlerësimit profesional, 3 (tri) dokumente ligjore, nga vlerësimi i të cilave ka rezultuar, sa vijon:

36.1 Diskutim përfundimtar, marrë në kuadër të procedimit penal nr. ***, për veprën penale “vjedhje”, parashikuar nga nenet 134/3 dhe 25 i Kodit Penal, në ngarkim të të pandehurve A. B., F. Z., E. Sh., dhe E. B. Nga akti i përzgjedhur rezulton se në gjykimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurve A. B., F. Z., E. Sh. dhe E. B., të akuzuar për veprën penale “vjedhje”, kryer në bashkëpunim, vepër e parashikuar nga nenet 134/3 dhe 25 i Kodit Penal është paraqitur “diskutimi përfundimtar”.

36.1.1 Nga përmbajtja e aktit procedural “diskutim përfundimtar”, Komisioni konstaton se:

- a. Subjekti nuk ka analizuar rrethanat e faktit penal, elementet e veprës penale, si dhe rrethanat rënduese apo lehtësuese që e kanë shtyrë të arrinte në konkluzionin për masën e dënimit prej dhjetë vjetësh për secilin të pandehur.
- b. Subjekti nuk analizon asnjë provë të administruar gjatë gjykimin.
- c. Subjekti i rivlerësimit nuk ka arsyetuar shkaqet ligjore të disponimit të tij mbi masën e dënimit.

36.2 Kërkesë për gjykim, marrë në kuadër të procedimit penal nr. ***, për veprën penale “organizimi i lotarive të palejuara”, të parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal, me të pandehur shtetasit J. V., dhe S. M. Ky dokument është përgatitur dhe përpiluar në kuadër të procedimit penal nr. ***, të vitit 2014, në ngarkim të të pandehurit J. V. dhe S. M., të akuzuar për kryerjen e veprës penale “organizimi i lotarive të palejuara”, të parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal.

Mbi bazën e materialit kallëzues nr. *** prot., datë 28.3.2014 të Drejtorisë së Policisë Qarkut Gjirokastër, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër ka regjistruar procedimin penal nr. ***, në datën 28.3.2014, për veprën penale “organizim i lotarive të palejuara”, të parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal.

Në mbështetje të nenit 331 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti i rivlerësimit, me kërkesën për gjykimin e procedimit penal nr. ***, viti 2014, ka paraqitur për gjykim procedimin penal në ngarkim të pandehurve J. V. dhe S. M., të akuzuar për veprën penale “organizim i lotarive të palejuara”, të parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal.

36.2.1 Dokumenti ligjor “kërkesë për gjykim” është i strukturuar dhe përmban të dhënat dhe elementet e kërkuara nga neni 331 i Kodit të Procedurës Penale. Në arsyetim përmenden normat e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale. Akti mban datën e përpilimit dhe nënshkrimin e subjektit të rivlerësimit.

36.3 Dokumenti ligjor “kërkesë për gjykim” marrë në kuadër të procedimit penal nr. ***, për veprën penale “goditje për shkak të detyrës”, parashikuar nga nenet 237 dhe 25 i Kodit Penal, me të pandehur shtetasit D. K., dhe K.H. Ky dokument është përgatitur dhe përpiluar në kuadër të procedimit penal nr. ***, për veprën penale “goditje për shkak të detyrës”, të parashikuar nga nenet 237 dhe 25 i Kodit Penal, me të pandehur shtetasit D. K., dhe K. H.

36.3.1 Nga përmbajtja e dokumentit të mësipërm, Komisioni konstaton:

- a. Subjekti rezulton se nuk ka analizuar provat e kësaj çështjeje në kërkesën e tij për gjykim.
- b. Subjekti rezulton se nuk ka përmendur në arsyetim normat e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale.

37. Nga vlerësimi i pesë dosjeve të përzgjedhura me short ka rezultuar, sa vijon.

37.1 Dosja 1. Kallëzim penal nr. *, datë regjistrimi 23.9.2015**, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër. Dokumenti ligjor - vendim “Për mosfillimin e procedimit penal”, mosfilluar datë 20.10.2015. Kallëzimi penal është regjistruar në prokurori, pas referimit të kryer nga komisariati i Policisë së Qarkut Gjirokastër, datë 23.9.2015, regjistruar në prokurori datë 23.9.2015.

37.1.1 Nga përmbajtja e dokumentit të mësipërm, Komisioni konstaton:

- a. Subjekti rezulton se nuk ka arsyetur vendimin për mosfillimin e procedimit penal.
- b. Baza ligjore për sa i përket vendimit të mosfillimit rezulton se nuk është e identifikuar saktë, pasi ajo e duhura është neni 290/1, germa “ç” e Kodit të Procedurës Penale.

37.2 Dosja 2. Procedim penal nr. *, regjistruar në datën 3.12.2014**, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë, për veprën penale “ndihmës për kalim të paligjshëm të kufirit”, të parashikuar nga neni 298 të Kodit Penal. Dokumenti ligjor-Vendim “Për pushimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2014”, datë 31.12.2014, hartuar nga subjekti i rivlerësimi.

Subjekti i rivlerësimit, me marrjen e materialit kallëzues, ka kryer veprimet e duhura procedurale që kanë të bëjnë me administrimin e praktikës ligjore për rastin objekt kallëzimi. Janë kërkuar të dhëna nga personi nën hetim F. L. Gjithashtu, nga policia gjyqësore është arrestuar në flagrancë shtetasi F. L., në datën 2.12.2014. Nga subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenet 228, 229, 251, 258 dhe 259 të Kodit të Procedurës Penale, është kërkuar që të vleftësohet i ligjshëm arrestimi në flagrancë dhe për të dyshuarin të caktohet masa e sigurimit e parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale, konkretisht, masa e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.

37.2.1 Në lidhje me këtë kërkesë, Komisioni konstaton se *subjekti i rivlerësimit rezulton se nuk ka argumentuar se përse duhet të vleftësohet arrestimi në flagrancë dhe përse duhet të caktohet masa e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.*

37.2.2 Nga përmbajtja e dokumentit “vendim për pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2014”, Komisioni konstaton:

- a. Vendimi i pushimit rezulton se është i paargumentuar, pasi subjekti i rivlerësimit jo vetëm nuk ka arsyetuar shkaqet ligjore të pushimit të çështjes, por mbi të gjitha nuk është shprehur për masën e sigurimit me karakter shtrëngues të personit nën hetim.
- b. Subjekti i rivlerësimit rezulton se nuk ka bërë asnjë analizë të figurës së veprës penale dhe arsyen se përse pushohet ky procedim penal.
- c. Baza ligjore e identifikuar nga subjekti rezulton se është e gabuar, pasi në vendim është vendosur si bazë ligjore e pushimit të procedimit penal neni 328/1, pika “c”, e Kodit të Procedurës Penale. Ligjvënësi ka parashikuar se kjo bazë ligjore shërben për pushimin e procedimit penal “i dëmtuari nuk ka bërë ankim ose heq dorë nga ankimi në rastet që procedimi fillon me kërkesën e tij”.
- d. Vendimi i është njoftuar të dëmtuarit nga vepra penale, por jo të hetuarit.
- e. Rezulton se subjekti nuk ka kryer një hetim të plotë nga regjistrimi i procedimit penal në ngarkim të autorit të dyshuar F. L., në datën 3.12.2014, deri në datën e vendimmarrjes “vendim pushimi”, datë 31.12.2014, pasi nuk ka kryer asnjë veprim hetimor të mëtejshëm.

37.3 Dosja 3. Procedim penal nr. *, regjistruar në datën 14.11.2015**, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë, për veprën penale “organizim i lotarive të palejuara”, të parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal. Dokumenti ligjor-Vendim “Për pushimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2015”, datë 14.11.2015, hartuar nga subjekti i rivlerësimit.

Subjekti i rivlerësimit, në datën 8.6.2015, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal me nr. *** dhe në datën 10.6.2015 ka urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore.

Me vendimin datë 14.11.2015, në bazë të germës “b”, të pikës 1, të nenit 328, të Kodit të Procedurës Penale, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e hetimeve në ngarkim të shtetasës A. R., në lidhje me procedimin penal nr. *** për veprën penale “organizim i lotarive të palejuara”, të parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal.

37.3.1 Nga përmbajtja e dokumentit vendim për pushimin e procedimit penal nr. ***, të vitit 2015, Komisioni konstaton:

- a. Subjekti i rivlerësimit rezulton se nuk ka arsyetuar në mënyrë të plotë dhe të qartë shkaqet ligjore të pushimit të çështjes.

b. Subjekti i rivlerësimit rezulton se nuk ka bërë analizë të figurës së veprës penale.

37.4 Dosja 4. Procedim penal nr. *, në datën 21.4.2012**, në Prokurorinë pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, regjistruar në emër të shtetasve Xh. I., M. P. dhe A. R., të cilëve u atribuohet vepra penale “vjedhje në bashkëpunim”, e parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal. Dokumenti ligjor - Kërkesë “Për gjykimin e procedimit penal nr. ***, viti 2012”, (mungon data), përgatitur nga subjekti i rivlerësimit.

Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, në datën 22.4.2012 ka paraqitur njëkohësisht në gjykatë kërkesën për vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë ndaj të pandehurve Xh. I., M. P., dhe A. R., dhe caktimin ndaj tyre të masës së sigurimit personal “detyrimin për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale.

37.4.1 Në lidhje me këtë kërkesë Komisioni konstaton se *subjekti i rivlerësimit rezulton se nuk ka argumentuar shkaqet dhe arsyet ligjore të vleftësimit të ligjshëm të arrestit në flagrancë, nuk ka arsyetuar nevojat e sigurisë në rastin konkret për caktimin ndaj të pandehurit të masës së sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale.*

Me vendimin datë 25.6.2012, subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 34 të Kodit të Procedurës Penale ka konkluduar në vendimmarrjen “Për marrjen e personit të pandehur dhe njoftimin e akuzës” dhe u ka njoftuar akuzën të pandehurve Xh. I., dhe M. P., të akuzuar për kryerjen e veprës penale “vjedhje në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal.

Në datën 20.7.2012, subjekti i rivlerësimit është shprehur për pushimin e hetimeve në ngarkim të të hetuarit A. R., me argumentin se “nuk ka prova” me bazë ligjore germën “dh”, të nenit 378/1.

37.4.2 Në lidhje me këtë vendim Komisioni konstaton:

- a. Është e paqartë se cila ka qenë arsyeja që subjekti ka pushuar çështjen vetëm për të pandehurin A. R.
- b. Vendimi i pushimit rezulton se është i paarsyetuar.
- c. Subjekti rezulton se nuk ka kryer një hetim të plotë.
- d. Baza ligjore rezulton se është e pasaktë dhe se e vendosur nga subjekti lidhet me “zhvillimin e diskutimit përfundimtar”, që nuk ka asnjë koherencë ligjore apo logjike me “pushimin e hetimeve”.

37.4.3 Nga aktet e fashikullit penal rezulton se subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet aktit procedural “Diskutim përfundimtar i procedimit penal nr. ***, të vitit 2012”, ka kërkuar:

- a. deklarin fajtor të të pandehurit Xh. I. për veprën penale “vjedhje”, të parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal;
- b. tërheqjen e akuzës në ngarkim të të pandehurit M. P., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “vjedhje”, të parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal, duke kërkuar gjithashtu edhe pushimin e gjyimit ndaj tij.

37.4.4 Me vendimin gjyqësor nr. ***, datë 16.5.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë është vendosur:

- a. deklarin fajtor të të pandehurit Xh.I., për veprën penale “vjedhje”, në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal;
- b. kalimin e akteve, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, për hetim të mëtejshëm që kanë lidhje me të pandehurin M. P.

37.4.5 Ky vendim ka marrë formë të prerë me vendimin e Gjykatës së Apelit datë 24.7.2013.

37.4.6 Në datën 30.12.2013, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit M. P., i akuzuar për veprën penale “vjedhje”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal.

37.4.7 Në lidhje me këtë vendim Komisioni konstaton:

- a. Subjekti i rivlerësimit rezulton se për arsye “extra procedurale” ka vendosur pushimin e procedimit penal.
- b. Subjekti rezulton se nuk ka argumentuar vendimin për pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit M. P.
- c. Rezulton se baza ligjore e referuar është e pasaktë.

37.4.8 Referuar aktit procedural, objekt shortimi, “kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. ***, viti 2012”, që subjekti i rivlerësimit ka paraqitur për gjykim para Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokastër rezulton:

- a. dokumenti ligjor “kërkesë”, në tërësinë e tij, është i pastrukturuar, i paargumentuar me mungesë të theksuar koherence ligjore dhe logjike;
- b. fakti penal parashtrohet nga prokurori në mënyrë të përmbledhur, por jo në kuadratin e kërkesave formale që parashikon neni 331 i Kodit të Procedurës Penale;
- c. në arsyetim nuk përmenden normat e Kodit Penal, por përmenden normat e Kodit të Procedurës Penale.

37.5 Dosja 5. Dokumenti ligjor “Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. ***, viti 2014”, (pa datë), përgatitur nga subjekti i rivlerësimit, me të pandehur shtetasin C. R., i akuzuar për veprën penale “prodhim dhe shitje i lëndëve narkotike” dhe “drejtim i mjetit në mënyrë të parregullt”, të parashikuar nga nenet 283/1 dhe 291 të Kodit Penal.

Pasi është siguruar për pyetjen e shtetasit C. R., në cilësinë e të pandehurit dhe njohjen e tij me materialet e çështjes, në datën 22.4.2014, subjekti i rivlerësimit, me cilësinë e prokurorit ka marrë vendimin për dërgimin e çështjes për gjykim. Vendimi është marrë konform nenit 327/2 të Kodit të Procedurës Penale.

37.5.1 Subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të nenit 331 të Kodit të Procedurës Penale, me “Kërkesë për gjykimin të procedimit penal nr. ***, viti 2014”, ka paraqitur për gjykim procedimin penal në ngarkim të të pandehurit C. R., para Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokastër.

37.5.2 Dokumenti ligjor “Kërkesë” është i strukturuar dhe përmban të dhënat dhe elementet e kërkuara nga neni 331 i Kodit të Procedurës Penale.

Nga përmbajtja e dokumentit të mësipërm konstatohet se janë respektuar rregullat e drejtshkrimit, fjalitë përgjithësisht paraqiten të qarta dhe përmbajnë referenca ligjore. Dokumenti paraqitet i strukturuar në mënyrë të rregullt dhe paragrafët janë të ndarë nga njëri-tjetri, si dhe teksti paraqitet i kuptueshëm. Në arsyetim përmenden normat e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale.

37.5.3 Nga verifikimi i dosjes rezulton se në përputhje me nenin 331 të Kodit të Procedurës Penale kërkesa nuk rezulton t’i jetë njoftuar të pandehurit, pasi në të nuk evidentohet nënshkrimi i të pandehurit.

38. Komisioni i Pavarur i Kualifikimi i ka dërguar shkresën nr. *** prot., datë 24.2.2020, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokastër dhe shkresën nr. *** prot., datë 24.2.2020, Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokastër, nga ana e tyre² është kthyer përgjigje duke vënë në dispozicion dosjen e procedimit penal dhe gjykimin në ngarkim të shtetasit G. S.

38.1 Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se në datën 7.12.2015 subjekti ka vendosur dërgimin e çështjes në gjykim të procedimit penal nr. ***, në ngarkim të të pandehurit G. S. për veprën penale “përndjekje” parashikuar nga neni 121/a/1 i Kodit Penal. Subjekti ka dërguar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokastër kërkesën për gjykim të procedimit penal nr. ***, në ngarkim të të pandehurit G. S.

²Shihni shkresën nr. *** prot., datë 25.2.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër dhe shkresën nr. *** prot., datë 10.3.2020, të Prokurorisë Gjyrokastër.

38.2 Nga analizimi i kërkesës Komisioni konstaton se:

- a. Dokumenti ligjor “kërkesë” rezulton se në tërësinë e tij, është i pastrukturuar dhe i paargumentuar.
- b. Subjekti rezulton se nuk analizon faktin penal dhe figurën e veprës penale “përndjekje”, të parashikuar nga neni 121/a/1 i Kodit Penal.
- c. Subjekti rezulton se nuk përmenden në arsyetim normat e Kodit Penal dhe normat e Kodit të Procedurës Penale.

38.3 Subjekti ka paraqitur kërkesën për vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit, duke kërkuar caktimin e masës së sigurimit arrest në burg. Në lidhje me këtë kërkesë, Komisioni konstaton se *subjekti i rivlerësimit rezulton se nuk ka argumentuar shkaqet dhe arsyet ligjore të vleftësimit të ligjshëm të arrestit në flagrancë, nuk ka arsyetuar nevojat e sigurisë në rastin konkret për caktimin ndaj të pandehurit të masës së sigurimit “arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.*

39. Në vijim të rezultateve për gjetjet në dosjet e përshkruara më lart, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit për të dhënë shpjegime dhe për të paraqitur prova në lidhje me këto konstatime, duke provuar të kundërtën.

40. Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar sa vijon: *“Në raportin tuaj rezulton se nuk jeni marrë me thelbin e një akti procedural që është vendimmarrja. Në asnjë prej akteve procedurale të vëzhguara nga ana juaj nuk evidentohet nëse vendimet e marra kanë qenë të drejta apo jo. Për këtë fakt kërkoj nga trupi gjykues, si dhe Grupi i Punës që ka hartuar raportin që të më jepet një përgjigje nëse vendimmarrja në këto akte ligjore ka qenë të drejtë apo jo. Theksoj se kam pasur mangësi në përpilimin e akteve procedurale për periudhën kohore 2014 në vazhdim, që ka ardhur si pasojë e mospërqendrimin në punë, përqendrim i ardhur nga problemet familjare të shkaktuara si pasojë e divorcit të ndodhur në vitin 2014. Këtë nuk po e them si justifikim, por është fakt.”*

41. Në vlerësim të shpjegimeve të subjektit dhe në frymën e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, trupi gjykues i Komisionit çmon se aftësitë profesionale të prokurorit duhen vlerësuar pa gjykuar në raport me korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet. Aspekti i arsyetimit ligjor të prokurorit në marrjen e vendimeve dhe veprimeve hetimore vlerësohet bazuar në tregues si qartësia dhe kuptueshmëria e akteve, cilësia e analizës dhe argumentimi logjik.

42. Nga verifikimi i të dhënave nga prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë, si dhe të burimeve arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme për subjektin e rivlerësimit ka rezultuar sa vijon:

42.1 Prokurori i Përgjithshëm ka nxjerrë vendimin me nr. ***, datë 15.12.2011, “Për fillimin e hetimit disiplinor” për prokurorin Spartak Çoçoli. Kjo vendimmarrje është bazuar në informacionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër dhe rezultatet e kontrollit nga Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore. Me urdhrin nr. ***, datë 16.2.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm, për këtë subjekt është dhënë masa disiplinore “vërejtje”.

42.2 Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. *** prot., datë 17.2.2020, ka informuar se Prokuroria për Krimet e Rënda Tiranë, në datën 14.1.2019 ka regjistruar procedimin penal nr. ***, në ngarkim të shtetasve:

- a. Spartak Çoçoli, i dyshuar për veprën penale “korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal;
- b. E.D., i dyshuar për veprën penale “korrupsion aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 319 dhe 25 të Kodit Penal;

- c. E.H., i dyshuar për veprën penale “korrupsion aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 319 dhe 25 të Kodit Penal.

42.2.1 Nga analizimi i fashikullit penal rezulton se:

- a. në datën 14.1.2019 është urdhëruar regjistrimi i procedimit penal nr. *** për veprën penale të korrupsionit aktiv të gjyqtarit, prokurorit, dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë, po ashtu edhe regjistrimi i emrit të personit që i atribuohet vepra penale si person nën hetim, prokurorit Spartak Çoçoli, pasi dyshohet për veprën e parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal;
- b. me vendimin nr. ***, datë 24.1.2019, të Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krime të Rënda Tiranë është caktuar ndaj subjektit masa e sigurimit personal me karakter ndalues: pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik, parashikuar nga neni 267/2 i Kodit të Procedurës Penale;
- c. në datën 21.6.2019 prokurori i çështjes ka vendosur të marrë të pandehur shtetasin Spartak Çoçoli për veprën e parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal;
- d. në datën 8.7.2019, prokurori ka paraqitur kërkesën për gjykimin e çështjes penale nr. *** të vitit 2019, ku një nga të pandehurit është edhe prokurori Spartak Çoçoli;
- e. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë me vendimin nr. ***, datë 30.10.2019, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit për dërgimin në gjykim të çështjes penale.

42.2.2 Aktualisht, kjo çështje po gjykohet me procedurë gjykimi të shkurtuar.

42.3 Referuar shkresës me nr. (*****) prot., datë 9.10.2018, të Drejtorisë së përgjimeve të komunikimeve elektronike dhe marrëdhënieve me shërbimet informative rezultojnë në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, informacione/*indicie* të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese në datat 29.6.2007, 10.10.2007, 24.12.2007, 6.10.2014, 25.4.2015, 24.5.2018, të titulluara në lëndë “Mbi *indicie* për veprimtari të kundërligjshme në sistemin e drejtësisë në Gjirokastrë”. Këto informacione, si më sipër i kanë kaluar njëkohësisht Prokurorisë për Krime të Rënda për kompetencë lëndore.

42.3 Nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e ankesave, në mënyrë manuale, për periudhën 2006 – 2018, rezulton se ka këto ankesa:

42.3.1 Praktika nr. *, viti 2008 nga shtetasja Sh. H.** Shtetasja pretendon prishjen e vendimit të pushimit, marrë në kuadër të çështjes penale me nr. ***, të vitit 2006, nga letra e ankimeses rezulton se nuk e ka ankimuar në gjykatë këtë vendim.

Lidhur me këtë ankesë, zyra e Prokurorit të Përgjithshëm i është përgjigjur ankueses me shkresën nr. *** prot., datë 6.10.2008, se: “*Pretendimet e parashtruara nga ana juaj kundër vendimit të pushimit të çështjes penale nr. ***, të vitit 2006, të datës 13.6.2008, nuk përbëjnë shkak ligjor për shfuqizimin e tij. Nëse do të vazhdoni të keni pretendime ndaj këtij vendimi mund t’i drejtoheni Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, në bazë të nenit 329 të Kodit të Procedurës Penale*”. Ndërkohë që po zyra e Prokurorit të Përgjithshëm me korrespondencën nr. *** prot., datë 10.4.2008, i është përgjigjur ankueses se në datën 8.4.2008 është vendosur shfuqizimi i vendimit të pushimit të datës 8.9.2006, marrë në kuadër të procedimit penal nr. ***, të vitit 2006.

42.3.2 Praktika nr. *, e vitit 2015 nga shtetasi A. B.** Nga institucioni i Presidentit rezulton se është dërguar ankesa e shtetasit A. B., ndaj masës së sigurimit të caktuar nga subjekti i rivlerësimit. Ankuesi është familjar i personit, i cili ka humbur jetën në aksident rrugor dhe sipas tij në mënyrë të padrejtë prokurori ka caktuar masën e sigurimit “detyrim paraqitje” për autorin. Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. *** prot., datë 14.1.2016, këtë ankesë ia ka përcjellë për zgjidhje drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë.

42.3.3 Praktika nr. *, e vitit 2015 nga shtetasja R. M.** Nga kjo praktikë rezulton se në një letër dërguar Prokurorisë së Përgjithshme, shtetasja R. M., ankohet për tejzgjatjen e disa

çështjeve penale të kallëzuara prej saj. Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. *** prot., datë 2.10.2015, këtë ankesë ia ka përcjellë për zgjidhje Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokastër.

42.3.4 Praktika nr. *, e vitit 2013 nga shtetasi A. S.** Nga kjo praktikë rezulton se në një letër dërguar Prokurorisë së Përgjithshme, shtetasi A.S., ankohet lidhur me moskryerjen e veprimeve hetimore me dashje, me qëllim zbardhjen e së vërtetës nga subjekti i rivlerësimit. Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. *** prot., datë 14.5.2013, këtë ankesë ia ka përcjellë për zgjidhje Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokastër.

42.4 Pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun ka të dhëna për vlerësimin e punës së këtij prokurori, të kryer nga Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 42 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i shfuqizuar si dhe Urdhrin nr. ***, datë 19.11.2012, “Për miratimin e rregullores për sistemin e vlerësimit të punës dhe aftësive profesionale dhe morale të prokurorëve”, konkretisht janë administruar:

- a. Vendim “Për vlerësimin e punës së prokurorit”, viti 2013, në nivel “mirë”.
- b. Vendim “Për vlerësimin e punës së prokurorit” viti 2014, në nivel “mjaftueshëm”.
- c. Vendim “Për vlerësimin e punës së prokurorit” viti 2015, në nivel “mirë”.
- d. Vendim “Për vlerësimin e punës së prokurorit” viti 2016, në nivel “mjaftueshëm”.

43. Në përfundim të analizës së mësipërme, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Spartak Çoçoli, tregon mangësi të theksuara në zbatimin të ligjit, pasi vetëm në një nga aktet procedurale ligjore të paraqitura prej tij (akti nr. 2) dhe në dy nga pesë dosjet e vëzhguara sipas shortit (konkretisht, në dosjen nr. 2 dhe nr. 5) është konstatuar se ka identifikuar drejt normën ligjore të zbatueshme. Në të gjitha rastet e tjera subjekti referon ligjin në mënyrë të gabuar. Në të gjitha rastet nuk analizon normën penale dhe procedurale penale të zbatueshme, mënyra e narratimit të faktit penal është larg gjuhës ligjore, por edhe me gabime drejtshkrimore të theksuar. Prokurori ka disponuar me vendim pushimi, në të gjitha rastet i paargumentuar dhe pa kryer veprime të tjera shtesë për të përligjur këtë vendimmarrje. Asnjë prej akteve të përzgjedhura apo të shortuara nuk ka analizë ligjore dhe paraqitje të faktit penal. Subjekti i rivlerësimit, në asnjë rast, nuk bën analizë të figurës së veprës penale dhe arsyen se përse pushohet/apo dërgohet në gjykim një procedim penal.

44. Subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi të “cunguara” në arsyetimin ligjor, përgjithësisht, referencat ligjore të vendosura në vendimmarrje janë të gabuara. Aktet e arsyetuara prej tij hera herës janë të kuptueshme, sepse përdoret më së shumti “zhargon”. Nga pikëpamja gjuhësore, nuk ka respektuar rregullat e drejtshkrimit në funksion të qartësisë së arsyetimit të aktit të përgatitur prej tij. Aktet e përpiluara prej tij janë të konceptuara në pjesën hyrëse, pjesë e cunguar e faktit penal dhe përherë të paargumentuara. Përmbajtja e akteve, përgjithësisht, nuk u ka dhënë përgjigje çështjeve të parashtruara për zgjidhje. Në përmbajtjen e akteve procedurale rezulton se përgjithësisht nuk formohet lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve të arritura nga prokurori. Subjekti i rivlerësimit, në asnjë rast, nuk ka analizuar dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me mënyrën e caktimit të dënimit. Niveli i arsyetimit të akteve të vëzhguara shfaqet nën kufijtë minimalë.

45. Subjekti i rivlerësimit, përgjithësisht, nuk ka ushtruar kompetencat që ligji i njej prokurorit, në drejtim të ushtrimit të ndjekjes penale, kontrollit dhe mbikëqyrjes së policisë gjyqësore. Shembull që reflekton këtë qëndrim është dosja nr. *** (nga dosjet e shortuara), ku si prokuror i çështjes ka oshilacion të pabazuar në prova dhe në ligj të qëndrimit të mbajtur gjatë hetimit dhe gjatë gjykimit. Vendimi i pushimit të çështjes është tërësisht i paarsyetuar dhe i pabazuar në ligj dhe në gjendjen në të cilën ndodhen aktet në fashikullin penal. Për sa i përket kërkesave për caktimin e masës së sigurimit personal, në asnjë rast, prokurori nuk argumenton arsyet se përse ndaj personave nën hetim duhet të caktohet masa me karakter shtrëngues “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Konkluzionet përfundimtare janë formuluar dhe nënshkruar nga prokurori i çështjes, por në asnjë rast nuk janë mirargumentuar.

46. Subjekti i rivlerësimit nuk i nënshtrohet Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.
47. Nga aktet e përzgjedhura nga subjekti, si dhe nga dosjet e hedhura në short, rezultojnë se përgjithësisht gjuha e përdorur në përpilimin e akteve nuk është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Vlen për t'u shtuar se subjektit të rivlerësimit i është dhënë masë disiplinore për aftësi të cunguara hetimore dhe organizative.
48. Nga të dhënat e deklaruara dhe të grumbulluara në lidhje me subjektin e rivlerësimit, rezultojnë se aktualisht është i pandehur dhe po gjykohet për veprën penale "korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë".
49. Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, evidentohen raste anësie në vendimmarrje pushimi të hetimeve të pabazuara në ligj dhe në prova (trajtuar më lart).
50. Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, në format letër dhe në tri dokumentet e dorëzuara prej tij, gjuha e përdorur në akte është larg gjuhës procedurale, komunikimi hera herës shfaqet në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.
51. Në përfundim, Komisioni konstaton se subjekti ka treguar njohuri, aftësi dhe cilësi të papranueshme në punë që nuk pajtohen me pozicionin e tij si prokuror.
52. Subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të dhënë shpjegime dhe për të paraqitur prova në lidhje me rezultatet e hetimit të Komisionit.
53. Në vijim, subjekti shpjegon: *"Për sa i përket faktit për mosmarrjen pjesë në aktivitetet trajnuese në kuadër të Programit të Trajnimit Vëzhgues të Shkollës së Magjistraturës, gjatë periudhës 3-vjeçare të rivlerësimit, si dhe jashtë kësaj periudhe, shpjegoj se mungesa nga ana ime në këto trajnime ka ardhur për shkak të ngarkesës së madhe në punë, gjë që evidentohet edhe nga raporti i Grupit të Punës, ku ngarkesa vjetore me dosje në hetim e gjykim ka qenë mesatarisht, duke mos përfshirë materialet kallëzuese, të cilat edhe ato arrinin në rreth 120, materiale kallëzuese në vit".*
54. Lidhur me dhënien e masës disiplinore dhe vlerësimin në punë, subjekti shpjegon se:
*"... është e vërtetë se me urdhrin nr. ***, datë 16.2.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm ndaj meje është dhënë masa e sigurimit disiplinore 'vërejtje', në lidhje me një akt procedural 'Zgjatje afatit të hetimit', në një procedim penal, që mund t'i ndodhi çdo prokurori për shkak të ngarkesës në punë.*
- Në lidhje me vlerësimet e punës të kryer ndaj meje për vitet 2012, 2013, 2014 dhe 2016, nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme për njohuritë ligjore, arsyetimet ligjore, aftësitë organizative, aftësia për të përballuar ngarkesën në punë, për të cilat jam vlerësuar, 'mjaftueshëm' në disa raste dhe 'mirë' në disa raste të tjera, dua të them se nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme nuk është ushtruar asnjëherë kontroll për punën time dhe nuk e di se si ka arritur në këto konkluzione. Kërkoj të më vihen në dispozicion nëse ndodhen pranë jush, raportet e kontrollit të kryer në këto vite."*
55. Në përfundim të shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit shprehet: *"Të nderuar anëtarë të trupit gjyqësor të subjektit të rivlerësimit Spartak Çoçoli, ndonëse e pranoj se kam disa mangësi, kërkoj që të konfirmohem si i përshtatshëm për të vazhduar detyrën e Prokurorit, për sa i përket komponentit të aftësive profesionale."*
56. Në Komision kanë ardhur pesë denoncime nga publiku, si vijon:
1. Denoncimi nr. *** prot., datë 18.5.2018, ku denoncuesi Z. S., bën ankesën për tre prokurorë, ndër ta është edhe subjekti i rivlerësimit. Problematika që ka ky shtetas lidhet me pronën e tij, të fituar me ligjin nr. 7501, ndërkohë pretendon se një familje tjetër me një dokument të falsifikuar e ka bërë si pronë të vetën, duke i bllokuar edhe kanalën ujitës. Ankuesi pretendon se kjo familje mbështetet nga subjekti i rivlerësimit dhe prandaj nuk do ta fitojë dot çështjen.

2. Denoncimi nr. *** prot., datë 14.2.2019, ku denoncuesi K. I., deklaroi se Gjykata e Rrethit Gjirokastër e ka dënuar me 18 muaj burg në gjendje të lirë për akuzën e përndjekjes së një shtetaseje, pa të drejtë dhe pa prova. Gjatë marrjes në pyetje nga subjekti i rivlerësimit, ai pretendon se nuk i është marrë në konsideratë një provë që dispononte, pikërisht, një video ku tregohet se çdo marrëdhënie është me dëshirë dhe nuk ka pasur detyrime apo përndjekje. Nuk ka të dhëna për çështjen konkrete, si dhe as akte bashkëlidhur.

3. Denoncimi nr. *** prot., datë 17.9.2018, ku denoncuesi V. Ç., denoncon disa subjekte, ndër ta edhe subjektin e rivlerësimit për vendim të padrejtë.

4. Denoncimi nr. *** prot., datë 8.10.2018, i përsëritur me denoncimin nr. *** prot., datë 15.10.2018, nga denoncuesi S. D., i cili denoncon disa subjekte rivlerësimi, ndër ta edhe subjektin e rivlerësimit. Denoncuesi ka bërë një kallëzim penal në prokurorinë Sarandë, ndaj një subjekti tjetër rivlerësimi, i cili i ka kaluar për vlerësim prokurorisë Gjirokastër dhe konkretisht, subjektit Spartak Çoçoli. Në kallëzimin e bërë, denoncuesi i parashtronte prokurorit të vlerësonte veprimet e gjyqtarës N. D., për heqjen e dokumenteve nga dosja civile dhe për shpërdorim detyre. Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit nuk e hetoi çështjen dhe ka kryer një sërë shkeljesh procedurale, duke ndihmuar kolegen e tij, gjyqtare në Sarandë.

5. Denoncuesi A. Ç., denoncon disa subjekte rivlerësimi, ndër ta edhe subjektin e rivlerësimit, z. Spartak Çoçoli. Subjekti i rivlerësimit ka shqyrtuar një kallëzim të bërë nga shtetasi A. Ç. dhe në përfundim ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Subjekti i rivlerësimit, në vendimin e tij, ka konstatuar se: shtetasi A. Ç., ka kryer një kallëzim penal pranë Sektorit Kundër Ekonomik Financiar DPQ Gjirokastër, ku pretendon se është pronar në një sipërfaqe toke në vendin e quajtur Virua Gjirokastër. Në këtë sipërfaqe toke, kallëzuesi shprehet se në mënyrë të paligjshme, dy kompani shfrytëzojnë sipërfaqen e tokës së tij mbi bazën e një lejeje zhvillimore infrastrukture, të lëshuar nga Bashkia Gjirokastër për të kryer rikonstruksionin e parkut Viroi. Kjo leje i është dhënë në mënyrë të paligjshme dhe për këtë fakt ai kërkon ndjekjen penale për personat përgjegjës.

Pas kryerjes së veprimeve hetimore nga subjekti i rivlerësimit, ka rezultuar e vërtetë se subjektet kanë cenuar pronësinë e shtetasit, por nuk e kanë pushtuar atë, e kanë shfrytëzuar. Ky shfrytëzim është bërë mbi një dokument ligjor të lëshuar nga Bashkia Gjirokastër. Në këto kushte konstaton se ndodhet përballë një dëmi të shkakuar ndaj kallëzuesit, dëm që i vendos palët në një konflikt civil gjyqësor, me qëllim dëmshpërblimin e të dëmtuarit. Ky fakt e përjashton evidentimin e përgjegjësisë penale të subjekteve që kanë vepruar në bazë të një lejeje nga Bashkia Gjirokastër. Duke mos u evidentuar përgjegjësia penale, procesi hetimor nuk mund të vazhdojë dhe në përfundim vendosi mosfillimin e procedimit penal.

Denoncuesi A. Ç., bëri ankim për shfuqizimin e vendimit të dhënë nga subjekti në Prokurorinë e Përgjithshme, e cila argumentoi se nga faktet e administruara në fashikullin penal rezultoi se konfirmohen pretendimet e shtetasit A. Ç., se në pronën që disponon me dokumente të rregullta janë kryer punime dhe ndërtime, të financuara nga Bashkia Gjirokastër pa dijeninë dhe lejen e pronarëve të tokës. Këto fakte e bëjnë të domosdoshme regjistrimin e procedimit penal “Shpërdorim i detyrës” dhe kryerjen e hetimeve të plota për sqarimin e rrethanave të faktit të kallëzuar.

Çështja iu dërgua për veprim Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër dhe prokurori i çështjes J. Ç., vendosi pushimin e procedimit penal për veprën penale “Shpërdorim të detyrës”.

Denoncuesi A. Ç., bëri kërkesë kundër këtij vendimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, në të cilën gjyqtari relator A. D., vendosi në përfundim të saj, rrëzimin e kërkesës.

57. Subjekti i rivlerësimit, në vijim të denoncimeve dhe materialeve bashkëlidhur të administruara në dosje, është shprehur sa vijon: *“Në lidhje me denoncimet e paraqitura pranë Komisionit, theksoj se nga ana juaj është kryer verifikimi përkatës dhe rezultoi se këto denoncime nuk qëndrojnë.”*

58. Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit konstaton se rezultatet e hetimit pasqyrojnë rrethana, të cilat lidhen drejtpërdrejt me veprimet dhe mosveprimet e subjektit të rivlerësimit, që janë konstatuar me gabime në referimin e dispozitës ligjore dhe evidentimin e rasteve të anësisë në vendimmarrje lidhur me pushimin e hetimeve si të pabazuar në ligj dhe në prova. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti kishte mundësinë për të sfiduar besueshmërinë e raportit të KLP-së, dhe konkluzionet e Komisionit të cilat i gjetën bindëse rezultatet e raportit të vlerësimit, në lidhje me aftësi të “cunguara” në arsyetimin ligjor, mangësi të theksuara në zbatim të ligjit, gjuhën e përdorur në përpilimin e akteve në përputhje me etikën profesionale të prokurorit apo aftësi dhe cilësi të papranueshme në punë, që nuk pajtohen me pozicionin e tij si prokuror. Shpjegimet e subjektit mbi rezultatet e hetimit administrativ ishin të përcipta, pa analizë dhe referenca konkrete. Po ashtu edhe subjekti ka pranuar se ka pasur mangësi në përpilimin e akteve procedurale.

59. Gjatë vlerësimit të rasteve, trupi gjykues i Komisionit vlerëson se subjekti i rivlerësimit gjendet në situata të përsëritura në shkelje të ligjit, të cilat rëndojnë pozitën e tij në drejtim të vlerësimit profesional dhe nuk mund të përmbushin kërkesat e germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016 dhe as ato të pikës 4, të nenit 59, të cilat në vlerësim të trupit gjykues lidhen me faktin se nëse shkeljet do të jenë të lehta, lejojnë subjektin të qëndrojë në sistemin e drejtësisë, pasi ato nuk e cenojnë sistemin e drejtësisë dhe besimin e publikut. Rastet konkrete të analizuar dhe të vlerësuara paraqesin një tablo të qartë të gabimeve thelbësore dhe serioze, gjithashtu ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara nga subjekti i rivlerësimit, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale.

60. Trupi gjykues vlerëson se në rastet kur gabimet e subjekteve të rivlerësimit evidentohen që përsëriten në mënyrë të vazhdueshme dhe në praktika të ndryshme, përbëjnë përjashtim nga rastet e konfirmimit në detyrë dhe ato duhet të vlerësohen negativisht. Në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të papranueshme në punë, gjykim të dobët, si dhe nuk ka respektuar të drejtat e palëve, ndaj ai konsiderohet “i papërshtatshëm”, pasi mangësitë vlerësohen të tilla që nuk mund të plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës.

61. Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivelin minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “c”, të ligjit nr. 84/2016, pasi rezulton i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale.

62. Nga vlerësimi në tërësi i rezultateve të hetimit lidhur me kontrollin e figurës dhe atë të vlerësimit profesional, trupi gjykues i Komisionit arrin në përfundimin se qëllimi dhe fryma e ligjit nr. 84/2016, në lidhje me kontrollin e figurës, kërkon që procesi i rivlerësimit të identifikojë gjyqtarët e prokurorët, të cilët kanë integritet të cenuar e që cenojnë besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, duke i përjashtuar ata nga sistemi i drejtësisë. Ligji, duke urdhëruar verifikimin, nëse subjektet kanë kontakte të papërshtatshme, nuk mund të përjashtojë verifikimin e figurës së subjektit nëse ka dyshime të bazuara se është përfshirë në korrupsion pasiv, ku nëpërmjetë ndikimeve të padrejta preket pavarësia në sistemin e drejtësisë si dhe/ose pavarësia e gjyqtarëve dhe prokurorëve si individë.

63. Rëndësia e integritetit të figurës së gjyqtarit apo prokurorit, duhet të qëndrojë në themel të procesit të rivlerësimit. Në këto kushte, konkluzionet e arritura gjatë hetimit të pastërtisë së figurës për z. Spartak Çoçoli, të ndërthurura me hetimin dhe vlerësimin e rasteve gjatë hetimit dhe vlerësimit profesional, vlerësohen se subjekti i rivlerësimit gjendet në situata të përsëritura në shkelje të ligjit, të cilat rëndojnë pozitën e tij si prokuror dhe kanë për qëllim anësi në vendimmarrjet e tij lidhur me pushim të hetimeve si të pabazuar në ligj dhe në prova. Këto veprime, të vlerësuara në tërësinë e tyre, cenojnë rëndë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, në kuptim të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

64. Përfundimet e mësipërme u vlerësuan të mjaftueshme nga trupi gjykues për të konkluduar lidhur me rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, mbështetur vetëm në kriterin e figurës dhe atë

të profesionalizmit, pasi çdo përfundim tjetër lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë nuk do të mund ta çonte Komisionin në një vlerësim të ndryshëm për zgjidhjen e çështjes.

65. Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues, bazuar në përfundimet e arritura, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit rezulton i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale pasi ndodhemi në kushtet e pamundësisë për plotësimin e tyre nëpërmjet programit të trajnimit. Nga vlerësimi tërësor i gjetjeve, lidhur me vlerësimin profesional, si dhe atyre lidhur me figurën rezulton se subjekti i rivlerësimit me veprimet dhe mosveprimet e tij ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, në kuptim të nenit E, pikat 4 dhe 5, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pikat 4 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues, bazuar në nenin E, pikat 4 dhe 5, të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 61, pikat 4 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Spartak Çoçoli.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 16.7.2020.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Lulzim HAMITAJ

Kryesues

Valbona SANXHAKTARI

Relatore

Xhensila PINE

Anëtare

*Sekretare gjyqësore
Gledis Hajdini*